



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**ZL.Anr.117/2017**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Adnan Konushevcu anëtar, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Alternativa dega në Gjakovë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Gjakovë, për shkak të vendosjes së panove reklamuese në objekt banesor, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 06.10.2017, mori këtë:

### **V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Alternativa dega në Gjakovë, e cila identifikohet me shenjën ZL.Anr.117/2017 e datës 02.10.2017, me të cilën ka kërkuar që të ndërmerren veprimet ligjore kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Gjakovë, për shkak të thyerjes së kodit të mirësjelljes për subjektet politike, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me datë 22.10.2017.

### **A r s y e t i m**

Me datën 02.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Alternativa, dega në Gjakovë, me të cilën pretendon se kanë marr pëlqim nga ana e Komunës për vendosjen e panos reklamuese në objektin banesor ish Bagati fasada veriore, ku është vendosur panoja reklamuese nga ana e subjektit politik Vetëvendosje, me ç ‘rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e rregullave zgjedhore.

Parashtruesi i ankesës ne cilësi te provave ka bashkangjitur 4 fotografi, kërkesën e dt.25.09.2017 dhe lejen-Pelqim ne lokacion të dt.28.09.2017.

Në përgjigjen në ankesë të datës 04.10.2017, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, të njëjtit nuk kanë pranuar shkeljen e pretenduar në ankesë duke theksuar se subjekti politik Alternativa ka bërë kërkesë me të cilën është dhënë pëlqimi për ndarjen e hapësirave reklamuese këtij subjekti, mirëpo para bërjes së kësaj kërkesë nga subjekti politik Alternativa dhe pranimi të saj, për ndarjen e hapësirave reklamuese nga Komuna e Gjakovës, LVV me dt. 20.09.2017, ka lidhur marrëveshje kontraktuale me kompaninë Selmans Network SHPK që të vëj në dispozicion hapësirë reklamuese në qytetet e ndryshme të përcaktuar në nenin 3 të marrëveshjes, duke përfshirë edhe Gjakovën. Në përgjigje në ankesë theksohet se sipas nenit 3 të marrëveshjes hapësira reklamuese në Gjakovë vendoset “Te KEK-u” që ka emërtim tjetër sipas marrëveshjes mirëpo vendi është i njëjtë, si dhe në pëlqimin e dhënë nga Drejtoria

për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit nr.07/353/01-20499 (objekti banesor “Ish Bagdati”).

Paneli, pasi që vlerësoj ankesën konstatoj se:

### **Ankesa është e pabazuar**

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesë lidhur me shkeljen e pretenduar të Kodit të Mirësjelljes nga ana e subjektit politik LVV, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se, veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të Kodit të Mirësjelljes në kuptim të dispozitës së nenit 33 pika b) të LZP-së, për arsye se vendosja e panos reklamuese të kandidatit për kryetar të Komunës të Gjakovës nga radhët e subjektit politik LVV, është në vendin e dedikuar për vendosjen e posterit.

Nga arsyet e theksuar më lartë dhe duke u bazuar në nenin 118 par.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

ZL.Anr.117/2017 më datën 06.10.2017.

**Kryesuesi i Panelit**

Rafet Haxhaj

***Këshillë Juridik:** Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, mirëpo PZAP-i, mund t'i rishikon cilindo nga vendimet e marra pas prezantimit të fakteve të reja nga pala e interesuar, në afat prej 24 orëve.*